



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 19 dhjetor 2016
Nr. ref.:RK1018/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI108/16

Parashtrues

Bojana Ivković, Marija Perić dhe Miro Jaredić

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 2016-COS-0488, të nxjerrë nga ushtruesi i detyrës së Shefit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, të 22 korrikut 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Bojana Ivković, Marija Perić dhe Miro Jaredić (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës). Ata përfaqësohen nga Axelle Reiter, avokate nga Brukseli, Belgjikë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin (nr. 2016-COS-0488, e 25 korrikut 2016) e nxjerrë nga ushtruesi i detyrës së Shefit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: EULEX). Nëpërmjet vendimit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës ishin njoftuar se kontratat e tyre të punës me EULEX-in nuk do të vazhdojnë pas 14 nëntorit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit] paragrafi 2; me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; me nenin 58 [Përgjegjësitë e Shtetit]; me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; dhe me nenin 61 [Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta). Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se ka pasur shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me nenin 6 (E drejta për gjykim të drejtë), paragrafi 1, dhe me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), si dhe të drejtat e garantuara me nenin 4, me nenin 5 dhe me nenin 6, paragrafi 2, të Konventës Kornizë për Mbrotjen e Pakicave Kombëtare (tekstin e mëtejshëm: KKMPK).
4. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht të pezullojë *“[...] procesin e përzgjedhjes së EULEX-it për të gjithë asistentët gjuhësorë ose, në rastin e Bojana Ivković [shënim i Gjykatës: një nga parashtrueset e kërkesës], pozitat e tjera në të cilat asaj i ishte dashur që t'i lejohej të konkurrojë pa marrë parasysh paaftësinë e saj për të lexuar, shkruar ose folur në gjuhën shqipe në pritje të gjykimit nga Gjykata për meritat e këtij rasti [...].”*
5. Parashtruesit e kërkesës më tej kërkojnë nga Gjykata që t'i *“[...] përjashtojë dhe/ose t'i lirojë të gjithë gjyqtarët e EULEX-it dhe këshilltarët ligjorë ndërkombëtarë të angazhuar në Kosovë nga pjesëmarrja në ndonjë shqyrtim zyrtar të kësaj kërkesë [Shënim i Gjykatës: kërkesa] [...]”*.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenet 18, 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 22 gusht 2016, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
8. Më 30 gusht 2016, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
9. Më 7 shtator 2016, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës EULEX-it dhe i ofroi mundësinë për të komentuar lidhur me kërkesën.
10. Më 8 shtator 2016, parashtruesit e kërkesës dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë, si shtojcë të kërkesës së tyre fillestare.
11. Më 19 shtator 2016, shefi i EULEX-it e dorëzoi një letër në Gjykatë ku thuhet se: “[...] EULEX-i nuk dëshiron të komentojë lidhur me kërkesën në këtë fazë”.
12. Më 16 nëntor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi njëzëri Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Parashtruesit e kërkesës janë punonjës të EULEX-it. Bojana Ivković ishte e punësuar si asistente administrative/gjuhësore (serbisht/anglisht) që nga 1 shtatori 2008. Marija Perić ishte e punësuar si asistente gjuhësore (serbisht/anglisht) që nga 19 marsi 2009. Miro Jaredić ishte i punësuar si asistent gjuhësor (serbisht/anglisht) që nga 21 janari 2010. Kontratat e tyre aktuale të punës janë kontrata me afat të caktuar në fuqi deri më 14 nëntor 2016.
14. Diskutimet ndërmjet autoriteteve përkatëse të Bashkimit Evropian dhe të Republikës së Kosovës për zgjatjen e mandatit të EULEX-it përtej afatit ekzistues në atë kohë, kishin filluar në vitin 2015. Në përgatitje për vazhdim të mandatit, EULEX-i njoftoi të gjithë punonjësit e tij, duke përfshirë edhe parashtruesit e kërkesës, se *“nëse mandati zgjatet, do të ketë riorganizim të Misionit që mund të çojë në reduktimin e të punësuarve”*.
15. Më 14 qershor 2016, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi Vendimin e Këshillit (CFSP) 2016/947, me të cilin ndryshoi Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP për Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.
16. Pas Vendimit të Këshillit, më 17 qershor 2016, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin nr. 05/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e Sundimit të Ligjit në Kosovë (në tekstin e mëtejme: Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare) dhe, më pas, Ligjin nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për mandatin e EULEX-it). Ligjet janë shpallur me Dekretin e Presidentit të

Republikës së Kosovës dhe janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 29 qershor 2016, duke rezultuar në zgjatjen e mandatit të EULEX-it deri më 14 qershor 2018.

17. Më 24 qershor 2016, ushtruesi i detyrës së Shefit të EULEX-it u dërgoi tri njoftime identike parashtruesve të kërkesës, me të cilat ata ishin informuar se ka ndodhur ristrukturimi i EULEX-it. Prandaj, parashtruesit e kërkesës u njoftuan në mënyrë individuale se:

“[...] pozita që ju keni pasur gjatë punës tuaj me EULEX-in nuk është e paraparë në periudhën e re të mandatit.

Prandaj, me këtë njoftim ju informoheni se kontrata juaj e punësimit nuk do të përtërihet pas 14 nëntorit 2016”.

18. Më 29 qershor 2016, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë të brendshme, duke kontestuar përmbajtjen e njoftimeve të përmendura më lart.
19. Më 22 korrik 2016, ushtruesi i detyrës së Shefit të EULEX-it (Vendimi nr. 2016-COS-0488) e refuzoi ankesën e brendshme të parashtruar nga parashtruesit e kërkesës. Vendimi i kontestuar u arsyetua si më poshtë:

“Ankesa e juaj parashtruar me kohë me të cilën kërkon anulimin e vendimit që dalin nga procesi i tanishëm i ri-konfigurimit ndikon në përtëritjen e kontratës së punës pas 14 nëntorit 2016, është refuzuar në këtë mënyrë. Kërkesa juaj alternative me të cilën kërkon kompensim për dëmet gjithashtu është refuzuar.

Në ankesën tuaj ju pohoni se efektet e caktuara të ri-konfiguracionit aktual janë duke rezultuar në diskriminim direkt apo indirekt etnik.

[...] Është shpjeguar në disa raste nga menaxhmenti i Misionit, si dhe nga Komandanti i Operacioneve Civile që këto ndryshime organizative janë të pashmangshme për përshtatjen e Misionit ndaj ndryshimit të mjedisit politik dhe ligjor. Më tej, Shtetet Anëtare ranë dakord për një tranzicion pesë muaj për të zbatuar këto ndryshime në mënyrë që të sigurohet një proces i drejtë dhe i barabartë i përzgjedhjes (ku është e nevojshme), si dhe të sigurojnë periudhë adekuate të njoftimit për ata që nuk mund të vazhdojnë me punësimet e tyre përkatëse. Ju gjithashtu mbani mend se kontratat e punës gjithmonë janë lëshuar për një periudhë të shkurtër me afat të caktuar, të përcaktuar nga mandati dhe/ose buxheti. Prandaj, asnjë nga kontratat e punës nuk është ndërprerë; disa nuk do të vazhdohen pas datës së skadimit të tyre përkatës. Misioni në asnjë rrethanë nuk është i detyruar që të ofrojë kontratë përtej skadimit të saj, megjithatë ne jemi të detyruar që të justifikojmë mos-zgjatjen eventuale me arsye të vlefshme dhe objektive, që në këtë rast është vetë rikonfigurimi [...]”

20. Më 27 korrik 2016, parashtruesit parashtruan kërkesë për zgjidhje të kontestit me anë të arbitrazhit, duke iu referuar dispozitave të kontratave të tyre përkatëse.

21. Kërkesa e parashtruesve të kërkesës për arbitrazh u refuzua nga EULEX-i në dy raste, më 4 gusht 2016 dhe më 8 gusht 2016, përkatësisht, me arsyetimin e mëposhtëm:

“EULEX-i konsideron [...] se kontrata juaj me afat të caktuar punësimi nuk është ndërprerë; ajo nuk është vazhduar pas skadimit të saj normal, më 14 nëntor 2016. [...] EULEX-i kupton se kërkesa juaj bie jashtë zbatueshmërisë së nenit 29 të Kushteve të Përgjithshme të Shërbimit, i cili parasheh arbitrazhin si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kontratës.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se EULEX-i, me nxjerrjen e vendimit të kontestuar, ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit] paragrafi 2, me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], me nenin 58 [Përgjegjësitë e Shtetit] dhe me nenin 61 [Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike] të Kushtetutës, në lidhje me të drejtat e tyre të garantuara me nenet 6.1 (E drejta për gjykim të drejtë) dhe 13 (E drejta për një zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, si dhe me të drejtat e tyre të garantuara me nenet 4, 5 dhe 6.2 të KKMPM.
23. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se në numrin e reduktuar të pozitive brenda EULEX-it, si pasojë e riorganizimit të tij, në të cilat punonjësit e afektuar, duke përfshirë edhe parashtruesit e kërkesës, duhet të konkurrojnë, janë futur kritere të reja, të cilat, sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, i diskriminojnë ata që të aplikojnë në ato vende të punës, për të cilat ata përndryshe do të ishin të kualifikuar. Parashtruesit e kërkesës veçanërisht kontestojnë përfshirjen e të ashtuquajturës *“kërkesë e trigjuhësisë”*, përkatësisht kërkesë e njohjes së gjuhës angleze, shqipe dhe serbe, për pozitat e asistentëve administrativë/gjuhësorë.
24. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se janë diskriminuar, duke pasur parasysh se *“asnjë nga kërkuesit [shënim i Gjykatës: parashtruesit e kërkesës] nuk mund të plotësojë këtë kërkesë”*. Ata gjithashtu pretendojnë se *“kërkimi i njohjes së gjuhës shqipe ka efektin e diskriminimit kundër nesh, sepse na pengon që të marrim pjesë në konkursin për post të ri të hapur në kuadër të Misionit dhe në këtë mënyrë na përjashton që të vazhdojmë me punësimin tonë”*.
25. Sipas parashtruesve të kërkesës, mungesa e vendeve të lira të publikuara rishtazi për pozitat për asistentë dygjuhësorë për gjuhën serbe-angleze, u pamundëson dy prej parashtruesve të kërkesës të aplikojnë për pozitat që aktualisht mbajnë, dhe të treve u pamundëson konkurrimin në ndonjë konkurs të brendshëm ose të jashtëm të EULEX-it. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se, duke pasur parasysh që rikonfigurimi i EULEX-it vazhdon të ofrojë disa pozita për asistentë dygjuhësorë për gjuhë angleze-shqipe, ata janë dëmtuar dhe janë diskriminuar karshi kolegëve të tyre shqipfolës.

26. Përkitazi me refuzimin e kërkesës së parashtruesve për zgjidhjen e kontesteve nëpërmjet arbitrazhit, ata i referohen faktit se *“neni 6 i KEDNJ-së i jep të drejtë çdo personi që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj”* dhe pretendojnë se EULEX-i u ka mohuar atyre këtë të drejtë, në kundërshtim me KEDNJ-në.
27. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se edhe pse *“aktor ndërkombëtar”*, EULEX-i është i angazhuar në ofrimin e shërbimeve publike në Kosovë, dhe për këtë arsye *“[...] është i detyruar të respektojë normat ndërkombëtare që ndalojnë veprimtarinë diskriminuese, sepse detyrat dhe obligimet e tij janë, mutatis mutandis, ato të një autoriteti publik në Kosovë”*. Ata më tej pretendojnë se EULEX-i *“është dhe ka të njëjtat detyrime dhe rregulla si një autoritet publik, pasi ai është një nga manifestimet e autoritetit të tillë publik në Kosovë”*.
28. Përfundimisht, parashtruesit i drejtohen Gjykatës me kërkesën e mëposhtme:

“Ne kërkojmë nga Gjykata që të deklarojë se EULEX-i në Kosovë ka vepruar në kundërshtim me të drejtat dhe liritë tona themelore të garantuara me nenet 3.2, 22, 24, 53, 58, dhe 61 të Kushtetutës, KEDNJ-së dhe Protokollet e saj, dhe KKMPK të Këshillit të Evropës.

Prandaj, ne kërkojmë nga Gjykata që të anulojë vendimet kontestuese dhe të urdhërojë që EULEX-i duhet së pari të angazhohet në procedurë për zgjidhjen e kontesteve kontraktuale dhe, së dyti, në ndërkohë, të mundësojë vazhdimin dhe/ose përfshirjen e parashtruese në funksionet e tyre, deri në përfundimin e procedurës për zgjidhjen e kontesteve, dhe në fund, që të veprojë në përputhje me rezultatin e procedurës në fjalë, dhe, në çdo rast të sigurojë kompensim adekuat në formë të dëmeve adekuate për humbje, dëmtim dhe vuajtje të shkaktuar tek ne deri më tani, si dhe interes.

Nëse EULEX-i refuzon që të përfshihet në procedurën e zgjidhjes së kontesteve kontraktuale, ne kërkojmë nga Gjykata që të urdhërojë që të hiqet imuniteti i EULEX-it nga paditë në gjykatat e Kosovës në favor të parashtruesve të kërkesës për qëllime të kufizuara duke u ofruar të drejtën parashtruesve që të bëjnë kërkesën e tyre në EULEX [...]. ”

Kërkesa për përjashtim

29. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata që të *“përjashtojë dhe/ose të lirojë të gjithë gjyqtarët e EULEX-it dhe këshilltarët ligjorë ndërkombëtarë të angazhuar në Kosovë nga pjesëmarrja në çdo shqyrtim zyrtar të kësaj kërkeje sipas rregullit 7 të Rregullores së punës për shkak të rrethanave të caktuara të cilat objektivisht sjellin dyshimin e arsyeshëm në pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre”*.
30. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, duke marrë parasysh që gjyqtarët ndërkombëtarë në Gjykatë paguhën nëpërmjet kontratave me EULEX-in, ata

“mund t’i nënshtrohen një vetëcensure të pavetëdijshme apo egoizmi sa që angazhimi i tyre në shqyrtimin, këshillimin si dhe përcaktimin e kësaj kërkesë arrin në mohimin e të drejtave të kërkuarve” [shënim i Gjykatës: parashtruesve të kërkesës] të garantuara me Kushtetutë për gjykim të drejtë para një gjykate të pavarur dhe të paanshme”.

31. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se në rrethana të tilla janë plotësuar kushtet për përjashtimin e gjyqtarit, siç parashihet me nenin 18 të Ligjit, pasi sipas tyre, gjyqtarët ndërkombëtarë në Gjykatë janë *“përfshirë në rastin që është objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese”*.
32. Gjykata së pari vëren se Ligji numëron bazat sipas të cilave një gjyqtar *“përjashtohet”* nga pjesëmarrja në procedurë gjyqësore. Një nga bazat përfshin situatën në të cilën një gjyqtar është i *“përfshirë”* në një rast që është objekt i shqyrtimit nga Gjykata. Ligji, megjithatë, jep përkufizimin e *“përfshirjes”* dhe, në paragrafin 2 të nenit 18, ai në mënyrë specifike përcakton se *“gjykatësi nuk është i përfshirë në çështje në kuptimin e paragrafit 1, pika 1.1. vetëm pse i takon një grupi shoqëror ose gjinor, një profesioni ose një partie politike interesat e së cilës mund të preken nga rezultati i procesit para Gjykatës Kushtetuese”*.
33. Së dyti, Gjykata vëren se parashtruesit e kanë bazuar kërkesën e tyre për përjashtim në baza të përgjithshme, abstrakte dhe identike, pa ndonjë referencë në fakte konkrete, materiale të cilat do të mund të kishin dëshmuar dhe objektivisht arsyetuar dyshimet në paanshmërinë e gjyqtarëve në këtë rast konkret (Shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), Aktgjykimin e 9 korrikut 2015, *A. K. kundër Lihtenshtajnit*, kërkesa nr. 38191/12).
34. Së treti, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesve ka të bëjë me përjashtimin në baza identike të dy (2) nga tetë (8) gjyqtarët në përbërjen e tanishme të Gjykatës. Gjykata rikujton se sipas Ligjit dhe Rregullores së saj të punës, ajo merr vendime në bazë të shumicës së votave, me kusht që të mbahet kuorumi prej shtatë (7) gjyqtarësh, siç përcaktohet me Ligj. Gjykata gjithashtu rikujton se sipas rregullit 7 (4) të Rregullores së punës, gjyqtarët, përjashtimi i të cilëve kërkohet, nuk mund të marrin pjesë në vendimin për përjashtimin e tyre. Rrjedhimisht, kjo kërkesë për përjashtim prek një numër më të madh të gjyqtarëve sesa numri i nevojshëm që kërkohet për të nxjerrë një vendim.
35. Në fund, Gjykata vëren se *“mundësia e përjashtimit të gjyqtarëve nuk duhet të rezultojë në pamundësinë e Gjykatës që të merr një vendim. Duhet të sigurohet që Gjykata Kushtetuese, si garantuese e Kushtetutës, vazhdon të funksionojë si një institucion demokratik”*. (Shih Komisionin e Venecias, Mendim nr. 370/2006, Mendim për dy projektligje për ndryshimin e Ligjit nr. 47/1992 për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Rumanisë, 20 mars 2006, p. 7; Komisioni i Venecias, Mendim nr. 833/2015 për ndryshimin e Ligjit të 25 qershorit 2015 i Gjykatës Kushtetuese të Polonisë, 11 mars 2016, p. 37; shih gjithashtu, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e 9 korrikut 2015 të GJEDNJ, *A. K. kundër Lihtenshtajnit*, kërkesa nr. 38191/12).

36. Rrjedhimisht dhe bazuar në arsyetimin e dhënë më lart, kërkesa e parashtruesve të kërkesës për përjashtim nuk mund të merret në konsideratë.

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], i cili përcakton:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

39. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit (Nr. 2016-COS-0488, të 25 korrikut 2016) të nxjerrë nga ushtruesi i detyrës së shefit të EULEX-it.
40. Gjykata rikujton se, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, individët janë të autorizuar vetëm që të *“ngrenë shkeljet e të drejtave dhe lirive të tyre individuale”*, ku këto shkelje të pretenduara janë kryer nga *“autoritetet publike”*. Me fjalë të tjera, individët mund të kërkojnë mbrojtje nga Gjykata vetëm në rastet kur ata konsiderojnë se të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga *“autoriteti publik”*.
41. Prandaj, Gjykata thekson se, për qëllim të përcaktimit të pranueshmërisë së kërkesës, është obligim i Gjykatës që të konkludojë nëse pretendimet për shkelje të ngritura nga parashtruesit e kërkesës mund t'i atribuohen një autoriteti publik të Republikën e Kosovës.
42. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për mandatin e EULEX-it (Nr. 05/L-103), në bazë të Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare (Nr. 05/L-102). Sipas marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare, Republika e Kosovës, në bazë të nenit 20 [Bartja e Sovranitetit] të Kushtetutës, ka bartur kompetenca të caktuara të autoriteteve të saj publike në Bashkimin Evropian në mënyrë që ato të zbatohen nëpërmjet EULEX-it. E njëjta marrëveshje ndërkombëtare gjithashtu garanton imunitetin e zyrave dhe të personelit të EULEX-it, si dhe të Përfaqësuesit Special të BE-së (PSBE), në pajtim me Ligjin nr. 03/L-033 për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatieke dhe Konsullore dhe Personelin e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake dhe Personelin e saj.

43. Në këtë drejtim, në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit (2008/124/CFSP, i 4 shkurtit 2008) të përmendur në Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare, EULEX-i është autoritet i ndarë nga ai i institucioneve të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në Kushtetutë. Sipas Veprimit të Përbashkët të Këshillit, Misioni i EULEX-it është që të “[...] ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumetnik të drejtësisë dhe të policisë shumetnike dhe shërbimit të doganave [...]”. Në përmbushjen e një misioni të tillë, EULEX duhet që të “monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës [...] derisa të mbajë përgjegjësi të caktuara ekzekutive”.
44. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës që EULEX-i duhet të konsiderohet si autoritet publik në Kosovë nuk qëndrojnë. Gjykata konsideron se nuk ka bazë ligjore e cila mund të çojë në përfundimin se EULEX-i është themeluar për të shërbyer si autoritet publik në Republikën e Kosovës dhe se ai duhet të konsiderohet si i tillë nga Gjykata Kushtetuese, ose nga ndonjë institucion tjetër në Republikën e Kosovës.
45. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 113.7 të Kushtetutës, përkatësisht që “*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë...*”.
46. Duke marrë parasysh se parashtruesit e kërkesës kontestojnë një vendim që nuk është një akt i një autoriteti publik të Republikës së Kosovës, në pajtim me rregullin 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] (3) (f) të Rregullores së punës, Gjykata e konsideron kërkesën të papranueshme, sepse nuk është *ratione personae* në pajtim me Kushtetutën.
47. Rregulli 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] i Rregullores së punës, përcakton:
- “*(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
- [...]
- (f) kërkesa nuk është ratione personae në pajtim me Kushtetutën*”.
48. Përfundimisht, duke pasur parasysh se kërkesa e tanishme shpallet e papranueshme, sepse nuk është *ratione personae* në pajtim me Kushtetutën, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e kërkesës.
49. Gjykata konkludon se pasi që parashtruesit nuk i kanë plotësuar kërkesat e parapara me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht edhe ato të parapara në nenin 47 [Kërkesat Individuale] dhe me nenin 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, në pajtim me rregullin 36 (3) (f) [Kriteret e Pranueshmërisë] e Rregullores së punës, kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

50. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht të pezullojë “[...] procesin e përzgjedhjes së EULEX-it [...] në pritje të aktgjykimit të gjykatës për meritat e këtij rasti. [...]”
51. Në paraqitjen e rastit të tyre, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ata do të pësonin dëme të pariparueshme „nëse EULEX-i vazhdon procesin e përzgjedhjes të pandërprerë gjatë procedurës në Gjykatë, ai do t’i emërojë, do t’i përmbyllë të gjitha konkurset dhe të caktojë të gjitha pozitat vendore në dispozicion duke mos lënë asnjë mundësi për [Shënim i Gjykatës: parashtruesit e kërkesës] vazhdimin e angazhimit tonë në Mision [...]”
52. Në mënyrë që Gjykata të vendosë masë të përkohshme, në pajtim me paragrafin 4 të rregullit 55 të Rregullores së punës, është e domosdoshme që:
- “(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin *prima facie* për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës;
- (b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme;...”
- Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës.”
53. Siç u përmend më lart, parashtruesit e kërkesës nuk kanë treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 18, 27 dhe 47 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullat 36, 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 nëntor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani
Gresa Caka-Nimani



Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi